
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data: 02.05.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE SET UNIFORMA DHE ELEMENTE PËRBËRËSE
PËR PERSONELIN E SHËRBIMIT TË URGJENCËS”**

**MARRËVESHJE KUADËR ME NJË OPERATOR EKONOMIK KU TË GJITHA
KUSHTET JANË TË PËRCAKTUAR**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) 18235400-
9; 18221200-6; 18235000-5; 18331000-8; 18234000-8**

VLERA E FONDIT LIMIT I MARRËVESHJES KUADËR: 49,943,467 (dyzet e nëntë milion
e nëntëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 506,988.80
(pesëqind e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë pikë tetëdhjetë) Euro pa TVSH.

*Shënim: Vlerat në Lekë në këto dokumente tenderi janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 02.05.2025, me kurs këmbimi 98.51 (nëntëdhjetë e tetë pikë pesëdhjetë e një) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes

tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar të arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit

kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009(të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin emnistrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. ”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit⁴⁵. Nëse kërkojnë bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitet ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitet ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

2.3 Kapaciteti teknik:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit

në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nëni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin

e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose te distributorit të autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi, në rast se nuk është prodhues. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Organi qëndror blerës, i cili kryen procedurën e prokurimit për llogari të Autoritetit Kontraktor përfitues Qendra Kombëtare e Urdhencës mjekësore, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues për mallrat që ata ofrojnë. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkojnë në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale për mallra sa më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit sipas specifikimeve teknike. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkojnë të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për artikujt objekt prokurimi është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent.

Për nga vetë natyra e artikujve objekt prokurimi dhe punonjësit e institucionit që do ti përdorë ato, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë, në datën dhe orën e hapjes së tenderit, nga një mostër për secilin prej artikujve objekt prokurimi sipas shtojcës 7. Mostrat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe të loguara sipas logos së kërkuar në specifikimet teknike, shtojca 6 e DST-së.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të

njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: “Rreshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e mostrave dhe skedat teknike si më sipër është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. 38 Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për artikujt objekt prokurimi, të përcaktuara si më sipër, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, llojin e mallit që kërkohet, specifikimet teknike të artikujve dhe aksesorëve që ato përmbajnë, të cilat janë të ndryshme për secilin artikull objekt prokurimi. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit. Kjo përfshin verifikimin e cilësisë së materialit të produktit final, dizenjimin e, dimensionet e kërkuara, si dhe karakteristika të tjera që lidhen me aksesorët që kanë këto artikuj, të cilat nuk mund të verifikohen përmes dokumentave të tjerë të kërkuara. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizat/ raport testimet e lëndës së parë për të gjitha artikujt e kërkuar sipas tabelës së shtojces 7, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar;

nenit 5 pika 1/a të ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laborator testues, mjekesor dhe kalibrues*”, si dhe Rekomandimit të përbashkët nr.3330, datë 20.03.2028 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe nr.145, datë 16.03.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet e testimeve zyrtare (raport/fletë-analizës), nëpërmjet të cilave duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e artikujve që ata ofrojnë me specifikimet teknike të objektit të prokurimit sipas përcaktimeve në dokumentet standarte të tenderit. Ky kriter është vendosur, gjithashtu duke iu referuar specifikimeve teknike ku verifikimi i disa elementeve të cilësisë së artikujve mund të verifikohet vetëm nëpërmjet analizave laboratorike për sa i përket lëndës së parë të përdorur për realizimin e produktit final. Fleta e analizës laboratorike garanton që materialet e përdorura për prodhimin e artikujve veshmbathje i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara, ku përfshihen lloji i lëndës së parë të përdorur dhe përbërësve të tjerë ndaj forcave mekanike, ujit, kimikateve apo faktorëve të tjerë që ndikojnë në performancën e produktit final. Fletë analizat sigurojnë që produkti përfundimtar do të jetë të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdorim afatgjatë. Siguria e përdoruesve të produktit përfundimtar, është një tjetër faktor që e bën të domosdoshme kërkesën për analiza laboratorike, duke i garantuar punonjësit që do ti përdorin, që produkti është i sigurt dhe mund të ofrojë mbrojtje adekuate daj rreziqeve të caktuara.

5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë produktet e përzgjedhura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues për llogari të të cilit Organi Qëndror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike nga prodhuesi ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare

akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

-ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar nën 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të certifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

ISO 9001: - Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. ISO 9001, sipas objektit të prokurimit, specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

7. Certifikatën OEKO-TEX standard 100 të tekstileve (ose ekuivalente) të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, për të vërtetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX standard 100 të tekstileve ose ekuivalente.

Argumentimi: Kjo lërkesë është në përputhje me pikën 1 e 3 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.... 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.”. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku përcaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të

lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Referuar specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi, Njësia e Prokurimit gjykon se është e domosdoshme paraqitja e certifikatës OEKO-TEX standard 100 të tekstileve (ose ekuivalente) të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, pasi është standarti që përfshin artikujt që kanë kontakt direkt me lëkurën dhe është në përputhshmëri me rregulloren e Bashkimit Europian që synon mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të kimikateve (Registration, Evaluation, Authorization and Restriction of Chemicals –REACH), duke përfshirë kufizimet për substanca të caktuara të rrezikshme. Ky standart certifikon produktet, pasi janë të testuara për substanca të dëmshme duke siguruar që të jenë të sigurta dhe të mbrojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga kimikatet toksike.

Cdo komponent i një produkti që nga lënda e parë (metrazhi) e deri të aksesoret, duhet të jenë testuar rigorozisht kundër shumë kimikateve toksike. Qëllimi i certifikatës është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm, përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit e deri në zinxhirin përfundimtar të furnizimit, ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar.

OEKO-TEX standard 100 të tekstileve (ose ekuivalente) është një nga etiketat më të njohura në botë për tekstilet e testuar për substanca të dëmshme. Ai garanton besimin e klientit dhe sigurinë e lartë të produktit.

Nëse një artikull tekstili mban etiketën STANDARD 100, konfirmon se çdo përbërës i këtij artikulli, d.m.th. çdo fije, buton dhe pajisje të tjera, është testuar për substanca të dëmshme dhe se artikulli është i padëmshëm për shëndetin e njeriut.

8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore..

Shënim: Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shënim: Bazuar në nenin 82 pika 4 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

*Përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike janë struktura të specializuara/ Grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët “ose ekuivalent”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIME - TEKNIKE

1. XHUP DIMEROR



Xhup me visibilitet të lartë multifunksional, i pa përshkueshëm nga lëngjet, lejon ajrosjen, kundër erës, transpirant i përbërë nga material poliestër dhe membranë PTFE ([polytetrafluoroethylene](#)) sipas normave AATCC 2013 dhe Rregullores 1007/2011 (EU), me dy shtresa dhe me astar në formë rrjete për ventilim ajri. Jaka e lartë me cope të dyfishtë me kapuç, i cili fshihet brenda jakës, mbyllet dhe bëhet pjesë e jakës me një velkro ngjitëse. Peri që do të prodhohen mostrat do të jetë sipas fijes së vetë uniformës.

6 percina (2 në pjesën e qafës dhe 4 në pjesën e bustit)

Copa e realizuar me materiale që përputhen me sistemin e kontrollit Oeko-Tex.

Dy xhepa vertikale të mbyllur me zinxhir në krahë, me gjatësi 14-16 cm.

Dy xhepa të pjerrët anësor të mbyllur me zinxhir me gjatësi 16-18 cm (në masën L), me mbrojtje reflektive dhe të mbuluar të pjesa e shiritit reflektiv të belit.

Xhep për vendosjen e radios në anën e majtë dhe lart të krahë, me gjatësi 13-15 cm, me një pjesë me rrjetë për dëgjimin e radios, me mbyllje me velkro nga lart.

Sistemi i rregullimit të gjerësisë (llastik me bllokues) një në lartësinë e belit dhe një në pjesën fundore të xhupit. Përforcime anti-rreshqitës mbi shpatulla, ngjyrë të zezë me pika të bardha. Në pjesët anësore zinxhir vertikale anësor për përshtatjen e xhupit me masën e trupit.

Të ketë vizë me ngjyrë evindetuese, të ndryshme nga ngjyra e xhupit (p.sh me vizibilitet të lartë, e verdhë, gri, blu etj), në pjesën e sipërme të jakës, pjesën e sipërme të kapucit, në lartësinë e

gjoksit, te kapakët e xhepave të poshtëm dhe në pjesën e pasme te pjesa e shpatullave. Largësia e vizës evidentuese nga qepja e jakës 12-14 cm.

Mbyllja përpara me zinxhir, siper tij kapak, qe mbyllet me perçina.

Mëngët e xhupit te kyci i dorës të jenë me velkro me ngjitje për rregullimin e madhësisë dhe me llastik për përshtatjen me kycin e dorës.

Një xhep të brendshëm drejtkëndor në krahun e majtë me mbyllje me ngjitje, në lartësinë e gjoksit.

Në krah të djathtë të gjoksit të ketë një velkro horizontale për vendosjen identifikuese të profesionit (mjek, infermier, shofer), me lartësi 1.5-2.5 cm dhe gjerësi 11-13 cm. Poshtë velkros të ketë një kuadrat (me përmasa lartësi 6-8 cm dhe gjerësi 9-11 cm) me ngjitje ose qepje direkte ose qepje (pec) të logos se QKUM.

Në pjesën e kyceve të dorës dhe qafës, të ketë një rrip rezistent në formë unaze, për kapjen me pjesën e brendshme termike.

Astari te jete ne forme rrjete.

Në pjesën e shpinës, 2-3 cm poshtë vizës evidentuese, të ketë te stampuar shkrimin URGJENCA (shkrimi Times Neë Roman, gërma kapitale lartësia shkrimit 4-6 cm, distanca ndërmjet shkronjave 0.5-1 cm,) dhe poshtë saj numrin 127 (shkrimi Times Neë Roman, lartësia e numrave 4-6 cm, distanca ndërmjet numrave 0.5-1 cm). Shkrimi të jetë i stampuar dhe reflektiv.

Dy shirita reflektive horizontale paralele me njëri-tjetrin të segmentuar (të ndërprerë) me teknologji mikro-sferike, të pozicionuara poshtë kraharorit dhe në pjesën e belit, si dhe në pjesën e krahëve ne lartësinë e shiritave te siperpermendur. Përmasat e shiritave: 4-6 cm pjesa e sipërme dhe 6-8 cm pjesa e poshtme.

Zinxhirët, përcinat, kapaku i xhepit të radios të jenë ngjyrë e zezë.

Pesha 205 gr/m² +/- 5%, Rezistenca ndaj avujve sipas normës SSH EN ISO 11092:2014, < 8 m²

Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, normat e certifikimit për Pajisjet për Mbrojtjen Personale, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës, vitin e prodhimit.

- Rezistenca ndaj depërtimit të ujit (norma EN20811): > 200 cm H₂O
- Qëndrueshmëria e copës (Norma SSH EN ISO 4674-1): Bazë > 90 N, Ind > 90 N
- Tërheqja e copës (Norma SSH EN ISO 1421): Bazë > 1200 N, Ind > 1200 N
- Soliditeti i ngjyrave në larje 40 gradë (SSH EN ISO 105 C06): Degradimi ≥ 4, Shkarkimi (poliestër – pambuku) ≥ 4
- Soliditeti i ngjyrave ndaj djersës, acideve dhe alkalineve (SSH EN ISO 105- E04): Degradimi ≥ 4, Shkarkimi ≥ 4;
- Metanal i lirë dhe pjesërisht i lëshuar SSH EN ISO 14184-1: Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2.

- pH e ekstraktit uhor SSH EN ISO 3071: Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- Të shmangen ngjyresit azoikë: Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2

Koha e përdorimit: 4 vjet. Koha e përdorimit të uniformave të personelit të urgjencës mjekësore është bazuar te standartet e shërbimit të urgjencës Mjekësore miratuar me urdhër të Ministrisë së Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i referohet kohës maksimale të përdorimit të artikujve.

Masat nga S deri ne 3XL.

Ngjyrë HV me kod #FE0100. Standardi EN 20471

Veshja termike e brendshme e xhupit

Veshja termike e brendshme e xhupit e çmontueshme, e përbërë me mbushje me material poliestër dhe veshja me material poliamide me qepje me struktura në formë rombi. Lidhet me xhupin me anë të dy zinxhirave anësorë dhe me një shirit në pjesën e kyçeve dhe qafës, në të cilin është e montuar perçina që lejon kapjen me xhupin dimëror.

Përbërja fibroze (AATCC 2013 + Reg. 1007/2011): copa e jashtme 100 % poliamid, mbushja 100 % poliestër, copa e brendshme 100 % poliamid.

Masa ajrore norma (SSH EN 12127:1999): pjesa e jashtme 70 gr/m² ± 5%, mbushja 100 gr/m², pjesa e jashtme 70 gr/m² ± 5%.

Në pjesën e belit të këtë një sistem rregullimi me llastik për përshtatjen me madhësinë e trupit. Në gjithë perimetrin dhe në pjesën e kyceve të këtë një shirit të fortë me qepje për bllokimin e materialit mbushës.

Certifikuar sipas normativave SSH EN ISO 13688:2013, SSH EN ISO 20471:2017 klasa 3,

2. PANTALLONA VERORE



Pantallonat verore të jenë të prodhuara me material bielasik, rip-stop (me kuadrate të vogla), që nuk lejon hyrjen e gjakut, lëndëve biologjike etj, me 5 xhepa.

Zmbraps ujin, lejon ajrosjen, kundra erës.

Përbërja fibroze (AATCC 2013 + Reg. 1007/2011): $\geq 90\%$ poliestër, $\leq 10\%$ elastan. Masa $195 \text{ g/m}^2 \pm 5\%$ sipas normës SSH EN 12127:1999 dhe rezistenca ndaj avujve të jetë $\leq 5 \text{ m}^2 \text{ PaË}$, sipas normës EN 11092. Peri që do të prodhohen mostrat do të jetë sipas fijeve të vetë uniformës.

Pjesa e gjunjëve të jetë e përbërë me material përforcues, kundër rrëshqitjes, që nuk lejon hyrjen e gjakut, lëndëve biologjike etj.

Mbyllje me zinxhir dhe me kapak me percina në pjesën e përparme.

Dy xhepat anësorë përpara te prerë në forme të pjerrët, të mbyllur me zinxhir dhe të mbuluar me kapak, me gjatësi 17-19 cm (në madhësinë L).

Dy xhepa të mëdhenj, me hapje fizarmonike, të mbyllur me zinxhir përpara, në pjesën e kofshëve, me zinxhir me gjatësi 16-18 cm.

Një xhep i pestë në pjesën e mbrapme të djathtë horizontal, i mbyllur nga një fileto me zinxhir me gjatësi 14-16 cm.

Mbyllje qendrore me gjysëm zinxhiri me gjatësi 14-16 cm dhe me percina, 5 ylyqe në bel (lartësi prej 5 cm dhe një gjerësi 2 cm), prej të cilave 2 në zonën e përparme dhe 3 në pjesën e pasme.

Të gjithë zinxhirët janë të pajisur me tërheqës me gjatësi 5-7 cm.

Fundi i këmbëve të pantallonave me bordurë te thjeshtë, me lak te brendshëm, të rregullueshem.

Dy shirita horizontal reflektiv të segmentuar (të ndërprerë) me teknologji mikro-sferike, te pozicionuar paralel në këmbë, në pjesën e kërcirit, një poshte gjurit dhe një sipër kavigjës, me lartësi 7-9 cm.

- Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, normat e certifikimit për Pajisjet për Mbrojtjen Personale, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës, vitin e prodhimit.
- Thurja (UNI 8099): Kanavacë efekti Ripstop
- Tërheqja e rrobave (SSH ISO 13934-1): Bazë $> 800 \text{ N}$, Ind $>> 1200 \text{ N}$
- Qëndrueshmëria e rrobave (SSH EN ISO 13937-1): Bazë $> 50 \text{ N}$, Ind $> 25 \text{ N}$
- Tërheqja e shtresave (SSH EN ISO 13935-2): $> 280 \text{ N}$
- Elasticiteti i rrobës (SSH ISO 14704-1): TENDOSJA- Bazë $\geq 30\%$, Deformimi (pas 30 minutash)- Bazë: $\leq 5\%$, Tendosja- Ind $\geq 30\%$, Deformimi (pas 30 minutash)- Ind: $\leq 5\%$
- Soliditeti i ngjyrave me dritë artificiale me llampë XENO (SSH EN ISO 105 B02): INDEX ≥ 4
- Soliditeti i ngjyrave në larje 40 gradë (SSH ISO 105 C06): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi (poliestër – pambuku) ≥ 4

- Soliditeti i ngjyrave ndaj djersës, acideve dhe alkalineve (SSH EN ISO 105- E04): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi ≥ 4
- Metanal i lirë dhe pjesërisht i lëshuar SSH ISO 14184-1: Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- pH e ekstraktit uxor SSH EN ISO 3071: Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- Të shmangen ngjyruetit azoikë: Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- Rezistenca ndaj gërryerjes SSH EN ISO 12947: ≥ 200.000 fërkime

Koha e përdorimit: 2 vjet. Koha e përdorimit të uniformave të personelit të urgjencës mjekësore është bazuar te standartet e shërbimit të urgjencës Mjekësore miratuar me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i referohet kohës maksimale të përdorimit të artikujve.

Masat nga XS deri ne 4XL.

Ngjyrë HV me kod #FE0100. Standardi EN 20471.

Certifikuar sipas normativave SSH EN ISO 13688:2013, SSH EN ISO 20471:2017 klasa 2,

3. **PANTALLONA DIMËRORE**



Pantallonat dimërore të jenë të prodhuara me material bielastik, rip-stop (me kuadrate të vogla), që nuk lejon hyrjen e gjakut, lëndëve biologjike etj.

Zmbraps ujin, lejon ajrosjen, kundra erës.

Përbërja fibroze (AATCC 2013 + Reg. 1007/2011): $\geq 90\%$ poliestër, $\leq 10\%$ elastan. Pesha $245 \text{ g/m}^2 \pm 5\%$ sipas normës SSH EN ISO 12127 dhe rezistencë ndaj avujve $\leq 5 \text{ m}^2 \text{ PaË}$, sipas normës SSH EN ISO 11092. Peri që do të prodhohen mostrat do të jetë sipas fijos së vetë uniformës.

Pjesa e gjunjëve të jetë e përbërë me material përforcues, kundër rrëshqitjes, që nuk lejon hyrjen e gjakut, lëndëve biologjike etj.

Mbyllje me zinxhir 14-16 cm dhe me kapak me percina në pjesën e përparme, 5 ylyqe në bel (lartësi prej 5 cm dhe një gjerësi 2 cm), prej të cilavë 2 në zonën e përparme dhe 3 në pjesën e pasme.

Dy xhepat përpara të prerë në forme të pjerrët, të mbyllur me zinxhir dhe mbuluar me kapak, me gjatësi 17-19 cm (në masën L).

Dy xhepa të mëdhenj, me hapje firzamonike, të mbyllur me zinxhir me gjatësi 16-18 cm, në pjesën e kofshës.

Në xhep mbrapa horizontal, i mbyllur nga një fileto me zinxhir me gjatësi 14-16 cm.

Të gjithë zinxhirët janë të pajisur me tërheqës me gjatësi 5-7 cm

Fundi i këmbëve të pantallonave elastik, me bordure të thjeshtë, me lak te brendshëm, të rregullueshëm. Në brendësi të fund të pantallonave të ketë një sistemit kapje me këpucën, nëpërmjet një ganxhe plastike dhe një rripi rregullues. Rripi rregullues të jetë i përbërë me material kundër rrëshqitjes.

Dy shirita horizontal reflektiv të segmentuar (të ndërprerë) me teknologji mikro-sferike, të pozicionuar paralel në këmbë, në pjesën e kërcirit, një poshtë gjurit dhe një sipër kavigjës, me lartësi 7-9 cm.

Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, normat e certifikimit për Pajisjet për Mbrojtjen Personale, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës, vitin e prodhimit.

- Thurja (UNI 8099): Kanavacë efekti Ripstop
- Tërheqja e rrobave (SSH EN ISO 13934-1): Bazë $> 800 \text{ N}$, Ind $>> 1000 \text{ N}$
- Qëndrueshmëria e rrobave (SSH EN ISO 13937-1): Bazë $> 50 \text{ N}$, Ind $> 60 \text{ N}$
- Tërheqja e shtresave (SSH EN ISO 13935-2): $> 250 \text{ N}$
- Elasticiteti i rrobës (SSH EN 14704-1): TENDOSJA- Bazë $\geq 30\%$, Deformimi (pas 30 minutash)- Bazë: $\leq 5\%$, Tendosja- Ind $\geq 30\%$, Deformimi (pas 30 minutash)- Ind: $\leq 5\%$
- Soliditeti i ngjyrave me dritë artificiale me llampë XENO (SSH EN ISO 105 B02): INDEX ≥ 4
- Soliditeti i ngjyrave në larje 40 gradë (SSH EN ISO 105 C06): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi (poliestër – pambuku) ≥ 4
- Soliditeti i ngjyrave ndaj djersës, acideve dhe alkalineve (SSH EN ISO 105- E04): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi ≥ 4

- Metanal i lirë dhe pjesërisht i lëshuar SSH EN ISO 14184-1: Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- pH e ekstraktit uxor SSH EN ISO 3071: Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- Të shmangen ngjyruetit azoikë: Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- Rezistenca ndaj gërryerjes SSH EN ISO 12947: ≥ 200.000 fërkime

Koha e përdorimit: 2 vjet. Koha e përdorimit të uniformave të përsonehit të urgjencës mjekësore është bazuar te standartet e shërbimit të urgjencës Mjekësore miratuar me urdhër të Ministrisë së Shëndetshisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i referohet kohës maksimale të përdorimit të artikujve.

Masat nga XS deri ne 4XL.

Ngjyrë HV me kod #FE0100. Standardi EN 20471

Certifikuar sipas normativave SSH EN ISO 13688:2013, SSH EN ISO 20471 :2017,

4. PULOVËR DIMËRORE



Pulovra me material poliestër, me zinxhir për hapje në pjesën e përparme, me mëngë të gjata, është e realizuar me material të butë, 100 % poliestër, pesha $240 \text{ g/m}^2 \pm 10 \%$, kundra pushavitjes, i lëmuar nga të dyja anët. Peri që do të prodhohen mostrat do të jetë sipas fijos së vetë uniformës. Me jakë të lartë me lartësi 5-7 cm, me ngjyrë të kuqe në pjesën e përparme dhe blu në pjesën e pasme (si ngjyra e vizave evidentuese). Vizë evidentuese në gjithë perimetrin e jakës.

Me mbyllje qëndrore me zinxhir, me gjatësi 65-67 cm (në masën L).

Një xhep Napoleoni vertikal në pjesën e djathtë të gjoksit, me mbyllje me zinxhir, me gjatësi 14-16 cm. Vizë evidentuese me ngjyrë të kuqe, në krah të djathtë të zinxhirit.

Në pjesën e sipërme të krahut të majtë të gjoksit, paralel me xhepin e krahut të djathtë të ketë një velkro horizontale për vendosjen identifikuese të profesionit (mjek, infermier, shofer), me lartësi 1.5-2.5 cm dhe gjerësi 11-13 cm. Poshtë velkros të ketë një kuadrat (me përmasa lartësi 6-8 cm dhe gjërësi 9-11 cm) me ngjitje ose qepje të logos se QKUM.

Dy xhepa të pjerrët në pjesën e përparme të poshtme dhe te mbyllur me zinxhir me gjatësi 16-18 cm.

Vizë evidentuese me ngjyrë të kuqe te kapakët e xhepave të pjerrët.

Pjesa e kyçeve, fundi i bluzës dhe pjesa anësore të jenë elastike për një përshtatje më të mirë.

Në pjesën e pasme në lartësinë e shpatullave të ketë të stampuar numrin 127 (largësia e numrave nga qepja e jakës 14-16 cm, shkrimi Times Neë Roman, lartësia e numrave 4-6 cm, distanca ndërmjet numrave 0.5-1 cm).

Në pjesën anësore të xhepave të poshtëm të ketë një trekëndësh me material elastinë dhe elastik për përshtatjen me masën e trupit.

Mëngët në pjesën e brendshme të krahut të ketë një shirit të gjerë nga sqetulla deri te kyçi me material elastinë dhe elastik me dopia qepje, për përshtatje me masën e krahut.

Poshtë shpatullave në pjesët anësore ngjitur me mëngët të ketë një trekëndësh të zgjatur me material elastinë dhe elastik për përshtatje me masën e trupit.

Qepjet të jenë dopio dhe syzator.

Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, normat e certifikimit për Pajisjet për Mbrojtjen Personale, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës, vitin e prodhimit.

Thurja (SSH EN ISO 4921): Triko me rrjetë të krehur

Rezistenca ndaj shpërthimit (SSH EN 13938): > 600 Kpa

Qëndrueshmëria e copës (Norma SSH EN ISO 13937-1): Bazë: > 50 N, Ind: > 40 N

Tërheqja e shtresave (Norma SSH EN ISO 13935-2): > 280 N

- Soliditeti i ngjyrave me dritë artificiale me llampë XENO (SSH EN ISO 105 B02): INDEX ≥ 5
- Soliditeti i ngjyrave në larje 40 gradë (SSH EN ISO 105 C06): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi ≥ 4
- Soliditeti i ngjyrave ndaj djersës, acideve dhe alkalineve (SSH EN ISO 105- E04): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi ≥ 4
- Metanal i lirë dhe pjesërisht i lëshuar SSH EN ISO 14184-1: certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- pH e ekstraktit uJOR SSH EN ISO 3071: certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- Të shmangen ngjyruarit azoikë: certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2

Koha e përdorimit: 2 vjet. Koha e përdorimit të uniformave të personelit të urgjencës mjekësore është bazuar te standartet e shërbimit të urgjencës Mjekësore miratuar me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i referohet kohës maksimale të përdorimit të artikujve.

Prerjet: Nga XS ne 4XL

Ngjyra: Blu, me jakë të kuqe

5. **BLUZA ME MËNGË TË SHKURTRA**



Bluze me mëngë te shkurtra, e prodhuar me material 100% poliestër bikomponentësh, pesha 160 g/m², norma SSH EN 12127, hidrofilik për nxjerrjen e djersës dhe lejimin e transpirimit të trupit nga brenda jashtë. Bluza ngelet e thatë, si rezultat i përbërjes bikomponente.

Qafë e lartë këmishe me lartësi 6-8 cm e hapur, që mbyllet me 3 kopsa. Qepje e sheshtë. Një xhep të thjeshtë në anën e majtë të gjoksit.

Material antibakterial, që nuk lejon aromën e keqe për rritjen e mikrobeve dhe për freskinë e lëkurës. Peri që do të prodhohen mostrat do të jetë sipas fijes së vetë uniformës.

Në lartësinë e gjoksit në krahun e djathtë të ketë të stampuar ose me qepje direkte ose qepje (pec) logon e QKUM-së, me gjerësi 9-11 cm dhe lartësi 3-4 cm në skajet më të larta.

Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, normat e certifikimit për Pajisjet për Mbrojtjen Personale, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës, vitin e prodhimit.

- Masa ajrore (norma SSH EN 12127:1999): 160 GR/MQ2± 5%
- Rezistenca ndaj shpërthimit (SSH EN 13938): ≥ 300 Kpa
- Variacioni i dimensioneve në larje (SSH ISO 6330): Bazë ± 3%, Ind: ± 3%
- Thurja (SSH EN ISO 4921): Bluzë
- Soliditeti i ngjyrave në larje 40 gradë (SSH EN ISO 105 C06): Degradimi ≥ 4, Shkarkimi (poliestër – pambuku) ≥ 4
- Soliditeti i ngjyrave ndaj djersës, acideve dhe alkalineve (SSH EN ISO 105- E04): Degradimi ≥ 4, Shkarkimi ≥ 4
- Metanal i lirë dhe pjesërisht i lëshuar SSH EN ISO 14184-1: certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- pH e ekstraktit ujqor SSH EN ISO 3071: certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- Të shmangen ngjyruarit azoikë: certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2

Koha e përdorimit: 2 vjet. Koha e përdorimit të uniformave të personelit të urgjencës mjekësore është bazuar te standartet e shërbimit të urgjencës Mjekësore miratuar me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i referohet kohës maksimale të përdorimit të artikujve.

Prerje : nga XS ne 4XL

6. JELEK



Jelek me jakë në formë “V” me përbërje fibroze 100 % poliestër, në formë rrjete, transpirant, pesha $145 \text{ g/ m}^2 \pm 5 \%$ norma SSH EN ISO 12127 dhe rezistencë ndaj avujve me pak se $2 \text{ m}^2 \text{ PaË}$, sipas normës SSH EN ISO 11092. Peri që do të prodhohen mostrat do të jetë sipas fijes së vetë uniformës.

Me mbyllje qendrore me zinxhir me gjatësi 48-52 cm. Paralel me zinxhirin në të dy anët të ketë një vizë evindetuese, të ndryshme nga ngjyra e xhupit (p.sh fosforeshente, e verdhë, gri, blu etjer), Të ketë dy viza me ngjyrë evindetuese, të ndryshme nga ngjyra e xhupit (p.sh fosforeshente, e verdhë, gri, blu etj), në pjesët anësore.

Në krah të djathtë në pjesën e gjoksit të ketë një xhep me mbyllje rrethore me gjysëm zinxhir me gjatësi 15-17 cm.

Në krah të djathtë të gjoksit, mbi xhep të ketë një velkro horizontale për vendosjen identifikuese të profesionit (mjek, infermier, shofer), me përmasa lartësi 1.5-2.5 cm dhe gjërësi 11-13 cm.

Poshtë velkros të ketë një kuadrat (me përmasa lartësi 6-8 cm dhe gjërësi 9-11 cm) me ngjitje ose qepje direkte ose qepje (pec) të logos së QKUM.

Në pjesën e shpinës të ketë te stampuar, qepje direkte ose qepje me qëndisje shkrimin URGJENCA (shkrimi Times Neë Roman, gërma kapitale lartësia shkrimit 4-6 cm, distanca ndërmjet shkronjave 0.5-1 cm, distanca e shkrimit nga bordura e qafës 14-16 cm) dhe poshtë saj numrin 127 (shkrimi Times Neë Roman, lartësia e numrave 4-6 cm, distanca ndërmjet numrave 0.5-1 cm). Shkrimi të jetë reflektiv.

Në krah të majtë të gjoksit të ketë një xhep vertikal me zinxhir.

Xhep për vendosjen e radios në anën e majtë dhe lart të kraharorit, me lartësi 13-15 cm (në masën L) me një pjesë me rrjetë për dëgjimin e radios, me mbyllje me velkro nga lart, të mbivendosur në një xhep me mbyllje vertikale me zinxhir me gjatësi 14-16 cm.

Dy xhepa anësorë në pjesën e poshtme të përparme me mbyllje rrethore me zinxhir, poshtë shioritit reflektiv horizontal me gjatësi 17-19 cm.

Dy xhepa vertikalë anësore, në krah të xhepave rrethorë me zinxhirë dhe kapakë, me gjatësi 16-18 cm (në masën L).

Një shirit horizontal reflektiv të segmentuar (të ndërprerë) me teknologji mikro-sferike ndërmjet xhepave të poshtëm dhe të lartëm dhe që vazhdon në gjithë perimetrin e trupit (edhe në pjesën e pasme), me lartësi 6-8 cm.

Dy shirita vertikalë reflektiv të segmentuar (të ndërprerë) me teknologji mikro-sferike, me gjerësi 4-6 cm, që nisen nga pjesa e përparme e shiritit horizontal, duke kaluar anash xhepave të sipërm, drejt shpatullave dhe përfundojnë te pjesa e pasme e shiritit horizontal.

Te pjesa e belit në pjesën e sipërme të xhepave të poshtëm, poshtë shiritit reflektiv horizontal të ketë llastik për përshtatje me masën e trupit.

Të gjithë zinxhirët janë të pajisur me tërheqës me gjatësi 5-7 cm.

Fundi me material elastik për një përshtatje më të mirë, me bordurë të zezë. Pjesa e mëngëve dhe jakës me bordurë të zezë.

Zinxhirët, kapaku i xhepit të radios dhe bordura e mëngëve të jelekut të jenë ngjyrë e zezë.

- Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, normat e certifikimit për Pajisjet për Mbrojtjen Personale, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës, vitin e prodhimit.
- Copa e thurur me gërshetim (SSH EN ISO 4921): Copë e thurur me prishje
- Rezistenca ndaj shpërthimit: ≥ 1000 Kpa
- Qëndrueshmëria e rrobave (SSH EN ISO 13937-1): Bazë ≥ 25 N, Ind ≥ 30 N
- Tërheqja e shtresave: ≥ 700 N
- Soliditeti i ngjyrave në larje 40 gradë (SSH EN ISO 105 C06): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi (poliestër – pambuku) ≥ 4
- Soliditeti i ngjyrave ndaj djersës, acideve dhe alkalineve (SSH EN ISO 105- E04): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi ≥ 4
- Metanal i lirë dhe pjesërisht i lëshuar SSH EN ISO 14184-1: certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- pH e ekstraktit uJOR SSH EN ISO 3071: certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2
- Të shmangen ngjyruetit azoikë SSH EN ISO 14362 pjesa 1: certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2

Koha e përdorimit: 4 vjet. Koha e përdorimit të uniformave të personelit të urgjencës mjekësore është bazuar te standartet e shërbimit të urgjencës Mjekësore miratuar me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i referohet kohës maksimale të përdorimit të artikujve.

Masat nga S deri ne 5XL.

Ngjyrë HV me kod #FE0100. Standardi EN 20471

Sipas standarteve SSH EN ISO 20471-2017 klasa 2, SSH EN ISO 13688:2013.

Afati i ekzekutimit do të jetë 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

LOGO E QKUM-SË

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6 /337 Tirane (në krah të Gjykatës së Lartë)– www.obp.al



Kodi i ngjyrës (red fluo) për uniformat është #FE0100.

Kodi i ngjyrës (dark navy) për pulovrën dimërore është #000034.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT